



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 3 Prot

Tiranë, më 18/02/ 2013

VENDIM Nr. 1 dt. 13.02.2013

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 13.02.2013, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës, sipas pikave të rendit të ditës:

Lidhur me: Diskutimin e kërkesës së shoqërisë "Gener 2" sh.p.k mbi objektin "Parkim nëntokësor", në sheshin Italia, Tiranë.

VENDOSI:

Projekti do të ridiskutohet në mbledhjen e radhës së KKR, pas reflektimit të sygjërimeve si më poshtë vijon:

1. Të minimizohet impakti vizual i strukturave mbitokësore në shërbim të parkimit (hyrje-dalje të vizitorëve).
2. Të mundësohet pozicionimi i strukturave mbitokësore në dy skajet e sheshit (veri- jug).
3. Rruga të shtrohet me të njëjtën teksturë dhe stil.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
ALDO BUMÇI

SEKRETARI I KKR
AKADEMIK APOLLON BAÇE

Rruga "Aleksandër Mojsiu", nr. 75, Tiranë (AL), Email: imk@albmail.com